



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30. janar 2012
Nr. ref.:RK193/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 30/09

Parashtrues

Agim Iliaz Dyla dhe të tjerët

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A.
Nr. 1360/08, të 19 qershorit 2009.**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues janë Agim Ilaz Dyla, Njazi Iliaz Dyla dhe Myrteza Iliaz Dyla, dy vëllezër e një motër, të cilët jetojnë në Gjakovë dhe e përfaqësojnë vetveten.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar është Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, A. Nr. 1360/08, i 19 qershorit 2009.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës ka të bëjë me kërkesën e parashtruesve për ta anuluar vendimin për shpronësim të pronës, që fillimisht ishte shpronësuar nga Komuna e Gjakovës në vitin 1969.

Baza juridike

4. Neni 113 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe neni 56 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesit e dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatë më 14 korrik 2009.
6. Më 29 janar 2010, në përputhje me nenin 22.2 të Ligjit dhe nenin 33.2 të Rregullores së punës, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës për përgjigje. Gjykata Supreme e Kosovës nuk ofroi përgjigje zyrtare për këtë kërkesë.
7. Më 15 qershor 2010, Gjyqtarja raportuese, Gjyljeta Mushkolaj, ia paraqiti raportin e vet Kolegjit shqyrtues, i cili përbëhej nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

Përmbledhje e fakteve

8. Më 11 qershor 1969, Komuna e Gjakovës, me Vendimin numër 03-477-1-1069 të Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, ia shpronësoi babait të parashtruesve ngastrat kadastrale Nr. 4350/1 dhe 4350/2. Ngastrat ishin shpronësuar në përputhje me nevojat e ndërmarrjes shoqërore "Sektori për shërbime dhe meremetime "Kompresor" - Gjakova".
9. Më 9 prill 2003, parashtruesit dorëzuan një kërkesë në qeverinë komunale të Gjakovës, me të cilën kërkonin anulimin e Vendimit 03-477-1-1069, të 11 qershorit 1969.
10. Pasi nuk e kishin marrë vendimin e Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, më 5 korrik 2005, parashtruesit dorëzuan edhe një kërkesë tjetër në Drejtori për vazhdimin e procedurës.
11. Në një datë të paraportuar, Drejtoria e shpalli veten jokompetente për t'u marrë me këtë çështje dhe ia dërgoi lëndën Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit. Megjithatë, pretendohet që Dhoma e Posaçme kurrë nuk e ka marrë lëndën.
12. Parashtruesit dorëzuan edhe një ankesë tjetër për heshtjen administrative të Drejtorisë. Si rrjedhojë, Agjencia Kadastrale e Kosovës nxori Konkluzionin Nr. 421/07, të 17 korrikut 2007, me të cilin e urdhëroi Drejtorinë që ta shqyrtonte këtë çështje brenda 15 ditëve nga Konkluzioni.

13. Më 11 shtator 2008, Drejtoria për çështje pronësore juridike e Komunës së Gjakovës nxori Vendimin Nr. 11-465-6/03-08, me të cilin e refuzoi kërkesën e parashtruesve për kthim të pronës.
14. Parashtruesit u ankuan kundër këtij vendimi në qeverinë komunale të Gjakovës dhe, më 5 nëntor 2008, kryetari i Komunës së Gjakovës nxori Vendimin Nr. 11-465-06/08-08, me të cilin e refuzoi kërkesën për ankesë.
15. Parashtruesit më pas paraqitën ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Më 19 qershor 2009, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin A. Nr. 1360/08, me të cilin e miratoi Vendimin e Drejtorisë për çështje pronësore juridike të Komunës së Gjakovës, Nr. 11-465-6/03-08, të 11 shtatorit 2009.

Pretendimet e parashtruesve

16. Parashtruesit ankohen se Vendimi Nr. 03-477/1-1969 i Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa të Komunës së Gjakovës, e cila e shpronësoi tokën e kontestuar, ishte nxjerrë për interes afarist, e jo për interes publik. Parashtruesit pohojnë që interesi publik parashihej me ligj.
17. Parashtruesit gjithashtu pohojnë që Drejtoria për çështje pronësore juridike e Komunës së Gjakovës padrejtësisht e vonoi marrjen e vendimit për këtë çështje. Parashtruesit theksojnë se kjo vonesë përfshinte injorimin e afateve kohore të përcaktuara me ligj dhe Agjencinë Kadastrale të Kosovës.
18. Parashtruesit më tej pohojnë që qeveria komunale e Gjakovës dhe Gjykata Supreme e Kosovës gabimisht e kishin përcaktuar ligjin në fuqi lidhur me shpronësimet. Qeveria dhe Gjykata Supreme zbatuan Ligjin e Kosovës për shpronësim (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78), të ndryshuar me Ligjin për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për shpronësim (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 46/86). Megjithatë, parashtruesit pohojnë që ligji në fuqi ishte Ligji i Serbisë për shpronësim.
19. Për këto arsye, parashtruesit pohojnë që Vendimi A. Nr. 1360/08, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i shkeli nenet 24 dhe 29 të Kushtetutës, dhe nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, që është i përfshirë në Kushtetutë përmes nenit 22.2.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme

20. Në Aktgjykimin e vet A. Nr. 1360/08, të 19 qershorit 2009, Gjykata Supreme e Kosovës i konsideroi pohimet e parashtruesve si të pabazuara. Gjykata Supreme konstatoi që dosja e lëndës qartazi tregonte se shpronësimi ishte bërë për nevoja të ndërmarrjes shoqërore, e jo për nevoja të afarizmit privat. Gjykata Supreme më tej theksoi se parashtruesit dështuan t'i verifikonin pretendimet e tyre.
21. Gjykata Supreme gjithashtu theksoi në Aktgjykimin e vet se kërkesa e parashtruesve për restituimin të pronës ishte e parashkruar, sepse sipas Ligjit për shpronësim (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78), Vendimi për shpronësim Nr. 03-477/1-1969 u bë përfundimtar në vitin 1969. Neni 21.4 i ligjit të sipërpërmendur thotë që vendimi përfundimtar për shpronësim mund të anulohet nëse pala shpronësuese nuk e ka kryer ndërtimin/zhvillimin e objektit të parapërcaktuar, nëse pronari i mëparshëm i pronës së shpronësuar paraqet kërkesë përkatëse brenda tri vjetëve nga momenti kur vendimi për shpronësim është bërë përfundimtar.

22. Neni 21.5 më tej përcakton që asnjë kërkesë për anulim të një vendimi të tillë nuk mund të paraqitet pasi të kenë kaluar 10 vjet nga data kur vendimi për shpronësim të jetë bërë përfundimtar.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Gjykata Kushtetuese përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
24. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkesë të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).
25. Megjithatë, pas shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara nga parashtruesit, Gjykata Kushtetuese nuk gjen ndonjë indikacion që procedurat kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (shih, *mutatis mutandis*, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Kërkesa Nr. 53363/99, Vendim i GJEDNJ-së, i 31 majit 2005). Gjykata Supreme dha arsye të mjaftueshme se përse ankesat e parashtruesit ishin të pabazuara dhe të parashkruara. Prandaj, rezulton që kjo kërkesë është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë.
26. Përfundimisht, sa i përket çështjes së kthimit të pronës, Gjykata Kushtetuese i referohet Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës. Aneksi XII i Marrëveshjes, në nenin 2 (Legjislacioni që zyrtarisht duhet të miratohet gjatë ose pas periudhës së tranzicionit), kërkon që Kuvendi ta miratojë "si çështje parësore pas përfundimit të periudhës së tranzicionit..." ndër të tjera, një "Ligj për restituimin e pronës" (neni 2.13).
27. Gjykata gjithashtu dëshiron të theksojë se vetë Kushtetuta e Kosovës, në nenin 143.3, përcakton se "*Kushtetuta ... do të interpretohet në pajtueshmëri me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës...*" Prandaj, edhe mbrojtja e pronës, e garantuar me nenin 46, gjithashtu duhet të interpretohet nga Gjykata në pajtueshmëri me Marrëveshjen.
28. Përveç kësaj, neni 143.1 i Kushtetutës përcakton që "*Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës veprojnë në pajtim me të gjitha detyrimet e Republikës së Kosovës sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës...*"
29. Sa i përket çështjes së restituimit të pronës, këto dispozita nënkuptojnë, ndër të tjera, që Kuvendi i Kosovës ka për obligim, si çështje parësore pas përfundimit të periudhës së tranzicionit (d.m.th. menjëherë pas 26 korrikut 2007), ta miratojë një "Ligj për restituimin e pronës". Megjithatë, Gjykata vëren që Kuvendi i Kosovës nuk ka miratuar një ligj të tillë deri më tani.
30. Gjykata gjithashtu vëren që në Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin e trashëgimtarëve Ymer Loxha dhe Sehit Loxha, KI 14/09, të 15 tetorit 2010, ajo ua rikujtoi autoriteteve të Republikës së Kosovës obligimin e tyre "*për ta themeluar një*

mekanizëm të pavarur për ta formuluar kornizën politike, ligjore dhe institucionale për shqyrtimin e çështjeve të kthimit të pronës, siç kërkohet me Aneksin VII, nenin 6.1 të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, dhe Kuendit për ta miratuar një ligj për restituimin e pronës, në pajtim me nenin 143 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 2.13 të Aneksit XII të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës”.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe nenit 56 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, me shumicë votash

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t’u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Dr. Gjyljeta Mushkolaj

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani